

KLSH, GARDIAN I FONDEVE PUBLIKEⁱ

nga Albana Agolli

Shqipëria është në një moment të veçante të saj. Janë disa momente në të cilat një vend i vogël si i yni dhe mundësitë që i afrohen atij për të konkuruar dhe për të qenë në qendër të vëmendjes, janë gjithmonë sinjifikative. Në momentet që po kalojmë, Kontrolli i Lartë i Shtetit(KLSH) ka një peshë të veçantë dhe sinjifikative, që duhet të jetë në qendër të vëmendjes në lidhje me performancën që ai duhet të paraqesë në publik.

Roli që luan KLSH në strukturën organizative të një shteti është shumë i rëndësishëm. Mënyra e funksionimit të këtij organi e bën atë të drejtpërdrejtë në luftën për përmirësimin e qeverisjes, kundër korrupsionit, abuzimeve me fondet publike etj, së bashku me organet e hetimit të një shteti.

“Lumi nuk sjell gjithmone kërcunj”, është një shprehje e vjetër popullore. Dhe vërtetë duhet të presësh shumë që të arrish rezultatet e kërkuara. Të duhet shumë përqendrim dhe sforcim për të arritur rezultate efektive në luftën kundër korrupsionit që shpesh nuk është i lehtë për tu arritur.

Durimi dhe intoleranca ndaj fenomeneve abuzive janë elementet bazë që mund të çojnë në përmbushjen e misionit të KLSH si gardian i fondeve publike. Ne ndihme te qytetarit dhe miradministrimit te fondeve publike, institucioni ka gjetur se borxhi publik i vendit eshte jashte kontrollit dhe rrezikon te rritet jashte çdo lloj parashikimi. Ka gjetur se buxheti eshte rishikuar shume here gjate vitit, duke demtuar rende disiplinën financiare. Dhe ka rekomanduar me force përgatitjen e një Buxheti realist, duke shmangur praktikën e vërejtur vitet e fundit të korrigjimit të Buxhetit në gjysmën e vitit financiar. KLSH ka kerkuar po ashtu me ngulm vendosjen e një tavani kushtetues për borxhin publik, në përqindje të Produktit të Brendshëm Bruto te vendit, me kusht që ai të tejkalohet vetëm në rastet e

emergjencave, katastrofave natyrore, dhe krizave ekonomike. Në rastet e tejkalimit të kufirit, KLSH ka rekomanduar që Qeveria të marrë masa për balancimin e Buxhetit. Nje buxhet realist, brenda mundesive per ta realizuar dhe kontrolli i borxhit publik jane levizjet kryesore per buxhetin e vitit 2014. KLSH ka kerkuar qe të vendoset në ligjin “Për Menaxhimin e Buxhetit” një nen që të ardhurat nga privatizimi të përdoren në rradhë të parë dhe jo më pak se 50 përqind, për uljen e Borxhit publik. Pra ky institucion kushtetues jo vetem rekomandon menytrat per shendoshjen e ekonomise dhe sherbimeve publike, por edhe jep zgjidhjet e mundshme. Për borxhin e Qeverisë ndaj kontraktorëve privatë, KLSH jep zgjidhjen e vendosjes në Ligjin “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014” të një neni që në të ardhurat nga privatizimet, nga pjesa e mbetur pas përdorimit të 50 përqind e lartë të fondeve për të ulur borxhin publik, shumica të shkojë për uljen e detyrimeve për faturat e papaguara ndaj sipërmarrësve privatë për punët publike të realizuara. Duke synuar heqjen e ngërçit që ka kapur kreditimin e ekonomisë, KLSH ka sygjeruar t’i kërkohet sistemit bankar, nëpërmjet bankës qendrore, që të mos bllokojë dhënien e kredive për kompanitë, të cilave Shteti u ka borxh. Duke parë akumulimin e një borxhi tatimor mbi gjysëm miliardë euro, institucioni i ruajtjes së parasë publike ka kërkuar me forcë zvogëlimin deri në arkëtimin e plotë të vlerës së borxhit tatimor dhe doganor. Të gjitha këto kërkesa e rekomandime vijnë në rezonancë të plotë me rekomandimet dhe këshillat e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore për shëndoshjen e financave tona publike. KLSH, njëlloj si këto institucione ndërkombëtare të asistences teknike, ka kërkuar konsolidimin dhe mirëfunksionimin e strukturave të menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit të brendshëm, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të miratuar dhe me kërkesat e parashtruara nga BE për vendin tonë, në kuadër të Kontrollit të Brendshëm Financiar të Sektorit Publik.

Në te gjitha analizat dhe llogaritjet profesionale që bëhen në këtë periudhë, Shqipëria ka fatin që nuk është nën presionin e krijimit të gjithshkaje nga fillimi, por ka një eksperiencë të konsoliduar të institucioneve të zhvilluara të auditimit suprem publik, partnerë të KLSH, si Zyra Kombëtare e Auditimit Shtetëror(NIK) e Polonisë, Gjykata e Auditimit e Austrisë, Gjykata e Llogarive e Turqisë, etj. Mund të marrim nga eksperiencia ndërkombetare gjithshka të mirë dhe të mundohemi të eliminojmë problematikën e ndeshur nga koha. Kështu që si KLSH dhe Shqipëria duhet të shfrytëzojnë shansin që i jepet.

Në atë që ka arritur në Shqipëri në këto dy vitet e fundit, KLSH nuk është se ka arritur majat, por ka ditur të ecë përpara mbi standardet profesionale të fushës, standardet INTOSAI. Referuar progres raportit të BE-së për Shqipërinë për vitin 2013, "*Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka përmirësuar performancën e tij, duke adoptuar një manual të ri për auditimin dhe duke kryer më shumë auditime... KLSH ka dorëzuar në Prokurori 40 kallzime për hetime penale (që përfshijnë 125 punonjës), dy herë më shumë se gjatë tre viteve të kaluara së bashku, duke theksuar në veçanti abuzimin me pronën publike nga administratorët publikë të rangut të lartë. Më shumë se dy të tretat e rekomandimeve të Institucionit janë zbatuar nga subjektet e audituara. Amendimet në Kuvend ndaj Ligjit organik të KLSH janë në pritje dhe po ashtu pritet të zbatohet një auditim i qëndrueshëm i performancës".*

Ky vlerësim nga një raport objektiv dhe tejet kritik si ai i Progres Raportit të BE-së, vërteton kontributin në rolin parësor të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si gardian i mirëfilltë i fondeve tona publike dhe kontribues në rritjen e përgjegjshmërisë publike dhe të mirëqeverisjes.

ⁱ Botuar në Gazetën "Telegraf", 25 Dhjetor, 2013